Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e te Dhënave Personale Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka National Agency for Protection of Personal Data	REPUBLIKA E AOSONÉS- REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OT KOSONO ALCINCIA SUTETEROBE PÉR MORIOTIENE TÉ OBEMAVE PERSONALE DRZAVNA AGENCIA Z ZAŠTITU LIČNIH PODITIVA METUDAL ACENCY FIRI NEVERIACI PROVINCI DATA ZINA E ANANTI-KANCELARIJA ARIMIVA-ARGINICE OFFICI ZINA E ANANTI-KANCELARIJA ARIMIVA-ARGINICE OFFICI Martina Ora One Data Martina Martina Data Data DAL DATA Data DAL DA ZO AZ PREISETTINE/A
	Nr prote2/2012

Nr. prot54/2012 Datë:13.11.2012

Në mbështetje të nenit 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 70/31 maj 2010) mbikëqyrësi kryesor shtetëror merr këtë:

VENDIM

- 1. Këshillohet Kolegji 'VICTORY' të marrë vendim për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë.
- Të vendoset njoftimi për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë. 2.
- Kolegji 'VICTORY' në afat prej 15 ditësh të njoftojë Agjencinë për zbatimin e këtij 3. vendimi.
- 4. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 (paragrafi 1, 1.4.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejmë LMDHP), më datë 06.11.2012, Agjencia ka realizuar kontrollin sipas detyrës zyrtare në Kolegjin 'VICTORY'.

Pas kontrollit është përpiluar procesverbali me nr.13/2012, i cili është nënshkruar nga personi përgjegjës dhe të njëjtit i është dorëzuar një kopje.

Në bazë të kontrollit të bërë, në procesverbal është konstatuar kjo gjendje:

Gjatë kontrollit që është bërë në Kolegjin 'VICTORY' është konstatuar se është i instaluar sistemi i vëzhgimit me kamerë, nuk është nxjerrë vendimi për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë,janë të vendosura 12 kamera nëpër korridore dhe para hyrjeve,dhe nuk ka kamera te vendosura ne vende te ndaluara.

Në nenin 62 (paragrafi 1) thuhet se personat në sektorin publik dhe privat mund të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë për vëzhgimin e ndërtesave të tyre, nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurimin e pasurisë. Vëzhgimi me kamerë, në veçanti, mund të jetë i nevojshëm për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave ose

> Adresa: Pejton Rr. Pashko Vasa Nr. 4, 10000 Prishtinë - Kosovë 1

aty ku, për shkak të natyrës së punës së tyre, ekziston kërcënim potencial ndaj të punësuarve.

Në nenin 62 (paragrafi 2 dhe 3) të LMDHP thuhet që vendimet e nevojshme merren nga nëpunësi kompetent, drejtori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga sektori publik ose privat. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për vendosjen e sistemeve të vëzhgimit me kamerë.

Në nenin 61 (paragrafi 2) parashihet që personat në sektorin publik ose privat që kanë për qëllim të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë duhet të vendosin njoftimin për këtë. Njoftimi i tillë duhet të jetë i dukshëm dhe të bëhet publik në mënyrë që t'i mundësojë subjekteve të të dhënave që pa vështirësi të njoftohen me masat, më së voni kur të ketë filluar vëzhgimi me kamerë.

Siç është përshkruar në arsyetimin e ketij vendimi, bazuar në nenin 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyrësi kryesor shtetëror ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë, por mund të hapet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit 'VICTORY'
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë



110

Ruzhdi Jashari

Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror

Adresa: Pejton Rr. Pashko Vasa Nr. 4, 10000 Prishtinë - Kosovë 2